



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrat

Office of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Anulimi i dëftesave, diplomave dhe dokumenteve të tjera shkollore dhe universitare të fituara në kundërshtim me ligjin ose që janë të lëshuara nga institucioni i palicencuar

NUMËR: MASHT [I] 39/2005

DATË: 28.09.2005

Në bazë të nenit 5.3 pika e), f) të Ligjit mbi Inspektionin e Arsimit në Kosovë dhe në bazë të nenit 1.3 pika ç) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT), nxjerr:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim të përcaktojë procedurën dhe rastet, kur inspektori i arsimit urdhëron anulimin e dëftesave, diplomave dhe të dokumenteve të tjera shkollore dhe universitare të fituara në kundërshtim me ligjin dhe dispozitat përkatëse nënligjore ose që janë lëshuar nga institucioni i palicencuar.

Neni 2

Rastet

Inspektori me qëllim të eliminimit të fitimit, lëshimit dhe përdorimit të dokumenteve shkollore dhe universitare të cilat janë në kundërshtim me ligjin, urdhëron anulimin e:

- a) dokumenteve të lëshuara në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore;
- b) dokumenteve të lëshuara nga personat e paautorizuar dhe institucionet e palicencuara;
- c) dokumenteve të falsifikuara;
- d) dokumenteve (dëftesave, diplomave, etj) të cilat nuk kanë mbështetje në dokumentet zyrtare të institucioneve arsimore;

- e) nëse inspektori konstaton se dëftesat, diplomat, etj. janë fituar (marrë) me anë të korrupsionit (mitos) apo në forma tjera të ngjashme.

Neni 3

Procedura e anulimit

- 3.1.** Pas konstatimit se një dokument është lëshuar në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, inspektori me vendim urdhëron institucionin për anulim. Nëse në afatin e paraparë me vendim, institucioni nuk e anulon dokumentin e përmendur, atëherë inspektori nxjerr vendim për anulim.
- 3.2.** Vendimi do t'i dërgohet personit dhe institucionit që e ka lëshuar dhe pranuar një dokument të tillë në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
- 3.3.** Institucioni ose personi që ka lëshuar dokumentin e tillë, obligohet që në afat prej 15 ditësh ta zbatojë vendimin e inspektorit.
- 3.4.** Pas konstatimit se dokumenti është lëshuar në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore, inspektori i arsimit fillon procedurën disiplinore ndaj përgjegjësit të institucionit ose personit tjetër të implikuar.
- 3.5.** Në rast të moszbatimit të vendimit të inspektorit në afatin e paraparë, do të shqiptohen sanksionet e parapara në Ligjin për Inspektionin e Arsimit neni 7.2 (b)

Neni 4

Regjistri i dokumenteve të anuluar

- 4.1.** Zyra e inspektimit në MASHT mban regjistrin e të gjitha dokumenteve të anuluar në nivel të Kosovës.
- 4.2.** Dokumentet e anuluar shpallen edhe në organin zyrtar të shpalljeve publike.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Agim Velu, ministër